




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raport i I
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin tetor 2017





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni t'ju bëj me dije se kjo zyrë synon të vendosë me ju një urë të re komunikimi përmes njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer.

Përmes këtij dokumenti, në kuadër të transparencës ju raportojmë kërkesat dhe sugjerimet e ardhura nga ju si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Gjithsej kemi trajtuar 51 kërkesa, prej të cilave 30 kërkesë/ankesa, pas këshillimeve dhe gjetjes së hapësirave ligjore për të trajuar çështjet, janë zgjidhur.

Çdo propozim që na mbërrin nga grupet e ndryshme të interesit, sipërmarrësit, apo shoqatat, koordinohet me ministritë përkatëse të parashikuara për zgjidhjen specifike të secilës çështje, ndaj një pjesë e këtyre propozimeve janë në proces përpunimi dhe do të raportohen në vijim.

Duke besuar se marrëdhënia Qeveri-sipërmarrje ka hyrë tashmë në një fazë të re, atë të konkretësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, lutem konsiderojeni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni cdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	25.09.2017	Subjekti raportues njofton për plotësimin e dosjes së aplikuar prej tij me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ministria, por pa gjetur ende rrugë shqyrtimi dhe zgjidhje të kërkesës së tij.	Trajtuar me përgjigje dhe udhëzuar subjekti për plotësimin e saktë të dosjes.
Nr.2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.09.2017	Subjekti investitor strategjik, që nga Dhjetori 2016 kërkon ti vihet në dispozicion nga ana e Bashkisë Fier, gjithë toka bujqësore prej 200 ha dhe toka truall për ndërtim të fabrikës. Nisëm e marrë përsipër nga ana e Qeverisë përmes marrëveshjes së mirëkuptimit dhe nxjerrjen e VKM-së përkatëse për kalimin e tokës pasuri e paluajtshme "shtet" në dispozicion të subjektit.	Trajtuar me përgjigje në ndjekje deri në mbarim të procedurave.
Nr.3	ZRPP	6.10.2017	Subjekti ka marrë lejen e spërdorimit të objektit në Bashki ndërkohë që nuk është regjistruar në ZRPP për mungesë dosjeje.	Trajtuar me përgjigje dhe ndihmë në regjistrimin në ZRPP.
Nr.4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	8.10.2017	Subjekti raporton vendosje gjobe për pasaktësi në prerjen e kuponit tatimor. Gjoha 330 herë më e lartë se vlera e kuponit.	Trajtuar dhe propozuar përmirësim i kuadrit ligjor.
Nr.5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10.10.2017	Raportim mbi lejen e zhvillimit lëshuar nga Bashkia Tiranë me Vendim Nr 1851/1 datë 30.01.2017 për Subjektin X dhe Subjektin ndërtues XX shpk, njësia Administrative Vaqarr, 4 kapanone për rritje shpendësh.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	8.10.2017	Subjekti i klasifikuar si shoqëri transporti, propozon rishqyrtimin e Udhëzimit të Ministrit të transporteve nxjerrë 2016.	Trajtuar dhe ngritur grupi për shqyrtimin e shoqatës së transportuesve ndërqytetas.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10.10.2017	Subjekti raporton se është ndëshkuar nga dogana për mospajisje me autorizim për prodhim mallrash akcize. Subjekti raporton se ka një vendim gjykate të formës së prerë i cili duhet zbatuar, duke hequr konfiskimin e makinerive dhe asgjësuar mallin e konfiskuar.	Trajtuar me zgjidhje nga autoriteti doganor.
Nr.8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.10.17	Subjekti raport se administrata kërkon ekstrakte QKB, vërtetime tatimore etj. me skadencë 3 mujore.	Trajtuar, nxjerrë udhëzimi i ministrit.
Nr.9	Drejtoria e Përgjithshme e Metereologjisë	23.10.2017	Raportim mbi problematika të inspektimit metrologjik.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.10	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	09.10.2017	Subjekti raporton problematikë me ERE	Trajtuar me përgjigje.
Nr.11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.10.2017	Subjekti kërkon tjetërsimin e tokës nga arë në truall.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.12	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	24.10.2017	Raportim në lidhje me çertifikatën orgjinale të konformitetit COC për targimin e mjete të reja.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.13	Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve Vendore	25.10.2017	Raportim problematike mbi tarifat vendore si biznes i madh.	Trajtuar me përgjigje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.14	FSSH	25.10.2017	Pengesë pune nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për kontrollin e kontratës me ISSH.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.15	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.10.2017	Departamenti i akcizës Doganë.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.16	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.1.2017	Kërkesë për mos-aplikim reference në Doganë.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.10.2017	Kërkesë për zbatim të drejtë të kodit doganor për klasifikimin e gabuar të kodit.	Trajtuar me përgjigje,në proces ndjekje.
Nr.18	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.10.2017	Amendim Vendim Dogane i cili është goditur në gjyq sipas kontrollit të KLSH.	Trajtuar me përgjigje,në proces ndjekje.
Nr.19	AMA	27.10.2017	Kërkesë për ndalim cënimi.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.20	Bashkia Kuçove	27.10.2017	Tenderi i pastrimit.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.21	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.10.2017	Përditësimi i statusit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.22	Ministria e Brendshme	28.10.2017	Kërkesë për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.23	ZRPP	28.09.2017	Subjekti raporton humbje të dosjes.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.24	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	29.10.2017	Përditësimi i statusit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.25	DPPI	29.10.2017	Kërkesë për opinion mbi varësinë e DPPI.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.26	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	29.10.2017	Shoqëri transporti që kërkon rishikimin e udhëzimit të ministrit të nxjerrë në muajin korrik 2017.	Trajtuar me ngritje grupi pune.
Nr.27	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.10.2017	Subjekti është ndëshkuar nga dogana për mospajisje me autorizim për prodhim mallrash akcize. Ka një vendim gjykatë të formës së prerë i cili duhet zbatuar, duke hequr konfiskimin e makinerive dhe asgjësuar mallin e konfiskuar.	Trajtuar me zbatim vendimi.
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.10.2017	Shoqëri transporti që kërkon rishikimin e udhëzimit të ministrit të nxjerrë në muajin korrik 2017.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.29	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	29.10.2017	Subjekti raporton mos mbyllje në Q.K.R. Gjobë në tatime që duhej të ishte hequr. Ndërkohë që vërtetimi te tatimet është pa detyrime.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.30	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1.11.2017	Shoqëri transporti që kërkon rishikimin e udhëzimit të ministrit të nxjerrë në muajin korrik 2017.	Trajtuar me zgjidhje.

